



C.nr.918/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-
Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti në çështjen
juridike të paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], kundër të
paditurës Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj të cilën e përfaqëson me autorizim
[REDACTED] në çështjen juridike kompensimi i të ardhurave personale, në prezencën e
paditësit dhe në prezencën e përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me dt.
15.06.2017, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] Rr. [REDACTED]
[REDACTED] nr. [REDACTED], e paraqitur kundër të paditurës Qendra e Mjekësisë Familjare në Ferizaj si
e bazuar.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj pagesën e të ardhurave
personale në emër të dëmit të shkaktuar në shumën e përgjithshme prej 656.84€,
(gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e katër cent), për periudhën
01.03.2016 deri më dt.31.04.2017, kurse në të ardhmen nga data 01.05.2017, për çdo
muaj duhet t'ia kompenzoj shumën nga 42.01€, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, si
dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 130€ në afat prej 7 ditësh, pas
plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësit në fjalën e tij ka deklaruar ka mbetur në tërësi pran padisë dhe kërkesë
padisë si dhe precizimit të kërkesë padisë duke shtuar se nga provat e administruara është
vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë, ku sipas kontratës së punës, e dt.01.03.2016,
është përcaktuar se detyrat dhe përgjegjësitë ku e paditura për punë e kryera është dashur
të më paguaj pagën mujore në lartësi prej 528€, të cilën kontratë e paditura pjesërisht e ka
përbushur, kurse sa i përket pagës mujore ka theksuar se jam dëmtuar materialisht për
çdo muaj nga 42.01€, e cila diferencë është vërtetua me përmes nxjerrjes së provës me
anë të ekspertit financiar, ku vërtetohej se prej dt.01.03.2016 deri me dt.31.04.2017 si
rezultat i mos përbushjes së kontratës nga ana e të paditurës jam dëmtuar në shumë të



përgjithshme prej 656.34€, si dhe nga data 01.05.2017 edhe më tutje dëmtona materialisht nga 42.01€ për çdo muaj, andaj ka kërkuar që të detyrohet e paditura që për periudhën 01.03.2016 deri me dt.31.04.2017 të më paguaj shumën prej 656.34€, si dhe për çdo muaj të detyrohet të paguaj shumën nga 42.01€ deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë ta aprovoj si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj ka deklaruar mbesim pranë përgjigjes në padi thëniet e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se e paditura kontratën në të cilën thirret paditësi e ka lidhur me vullnetin e të dy palëve por deri te mos ekzekutimi i saj në lidhje me pagën mujore kjo ka ardhur si rezultat i të cilës nuk e ka bërë Ministria e Financave e jo e paditura edhe përkundër asaj që e paditura ka bërë kërkesë që e njëjta të ekzekutohet, por është refuzuar nga Ministria e financave me arsyetim se vendi i punës i paditësit tek e paditura hy në kategorinë e shërbyesve civil, e cila për të paditurën nuk qëndron.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që në raport me kërkesë padinë e paditësi të vendos sipas ligjit.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë ushtrimin e provave, U lexua padia e paditësit C.nr.918/16 e dt.28.12.2016, kërkesa-parashtresa e paditësit drejtuar të paditurës në procedurë administrative e dt.18.11.2016, me nr.protokolli 1245, kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës e dt.01.03.2016, përgjigja në padi e të paditurës e dt.06.02.2017, autorizimi i të paditurës dhënë përfaqësuesit [REDACTED], ekspertiza e ekspertit financiar [REDACTED] e dt.28.04.2017, formulari i të dhënave në listën e pagave.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese se ekziston marrëdhënia e punës mes paditësit dhe të paditurës, në bazë të së cilës janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet ndërmjet palëve kontraktuese.

Me kontratën e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës e dt.01.03.2016, në nenin 2 të kësaj kontrate është e përcaktuar detyrat e punës që ka paditësit, kurse në nenin 7 të kësaj kontrate është përcaktuar se paga mujore për punën të cilën e kryen paditësi të jetë 528€.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, lidhur me nenin 154 dhe 189 të LMD-së duke u bazuar në mendimin e ekspertizës së ekspertit financiar [REDAKTUAR], mendimin e të cilit e vlerësoi në tërësi si profesional dhe objektiv, si dhe dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës të administruara si prova në këtë çështje juridike.

Për paditësin gjykata në emër të ardhurave personale në emër të dëmit të shkaktuar, për periudhën 01.03.2016 deri me dt.31.04.2017, ka caktuar lartësinë e shpërblimit në shumë prej 656,34€, e cila shumë është përlogaritur nga ana e ekspertit financiar duke bërë krahasimin e pagës që është përcaktuar në kontratë dhe pagës të cilën e merr paditësi si dhe detyrimet kontributit pensional, kurse nga data 01.05.2017, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore e paditura duhet t'ia paguaj paditësit për çdo muaj nga 42.01€, në emër të mos përmbushjes së kontratës së punës të dt.01.03.2016, për vendin e punës përgjegjës për shërbimin e SISH dhe IT-së në QKMF Ferizaj.

Gjykata nga provat e administruara kontrata e punës është përcaktuar se e paditura duhet në emër të detyrave të punës që i janë caktuar paditësit me këtë kontratë ta paguaj në shumë prej 528€, për çdo muaj, të cilin detyrim e ka përmbushur pjesërisht duke e paguar vetëm në lartësi prej 487.93€, e me të cilin veprim paditësi dëmtohet materialisht për çdo muaj nga 42.01€, kurse prej dt.01.03.2016 deri me dt.31.04.2017 është dëmtuar në shumë prej 656.34€, i cili dëmtim ka ardhur me veprimet e të paditurës e jo të paditësit.

Gjykata konsideron se e pretendimet e të paditurës se Ministria e Financave nuk e ekzekuton kontratën e punës në raport me pagën e përcaktuar në atë kontratë dhe faji është i Ministrisë e jo i të paditurës, këto pretendime janë të pa bazuar për gjykatën për faktin se e njëjta është dashur paraprakisht të konsultohet me zyrën ligjore apo të thesarit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me ekzistimin e buxhetit për paga në raport me detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë e pastaj të përcaktohet paga e jo paditësi të

dëmtohet materialisht për shkak të mos marrëveshjeve të cilat janë shfaqur në ndërkohë në mes të paditurës dhe Ministrisë së Financave ashtu siç pretendon e paditura në lidhje me pamundësinë e ekzekutimit të kontratës sa i përket pagës mujore që është përcaktuar në kontratë.

Duke marr parasysh se paditësi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësisë sipas kontratës së punës të dt.01.03.2016, kurse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj në nenin 7 të kësaj kontrate sa i përket pagës mujore, gjykata konsideron se duke u bazuar në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës ku është e përcaktuar qartë se i punësuar ka të drejtë në pagë e cila i caktohet me kontratën e punës e në pajtim me këtë ligj, kontratën, kontratën kolektive apo me akt të brendshëm të punëdhënësit, andaj në rastin konkretë paditësi nuk mund të pësoj nga mosmarrëveshjet që kanë e paditura me Ministrinë e Financave por i njëjti duhet të realizon pagës që është përcaktuar në kontratë, pasi që i njëjti nga ana e tij i kryen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë në raport me të paditurën.

Paga e paditësi sipas kontratës rezulton të jetë 528 €, kurse pagesa në emër të detyrave të punës i njëjti paguhet për çdo muaj nga 487.93, është në kundërshtim me kontratën e punës dhe me Ligjin të Punës, andaj gjykata konsideroj se pretendimet e paditësi janë të bazuara.

Sa i përket detyrimit të paditurës që paditësi t'ia kompenzoj për çdo muaj duke filluar nga data 01.05.2017, shumën nga 42.01€ deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, kjo nënkupton deri sa do të ketë ndonjë ndryshim në mes palëve ndërgjyqëse në lidhje me marrëdhënien e punës, dhe lartësinë e pagës.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka marr parasysh gjithnjë edhe pretendimet tjera që përfaqësueses të paditurës, por nuk kanë pasur ndikim për ndonjë vendim ndryshe.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj e paditura obligohet që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 130€, dhe atë në emër të ekspertizës financiare shumën prej 100.00€, €, taksën gjyqësore për padi 15€ dhe aktgjykim prej 15€, e cila është llogaritur në bazë të vlerës së kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.918/16 dt.15.06.2017

Gjyqtari,
Alban Beqiri



KESHILLA JURIDIKE, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOZNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

